**VENDIM**
**Nr.4, datë 7.1.2009**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, e 25, pika 4 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 21, të vendimit nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"21/1 Në tekstin e projektaktit me karakter normativ, që kërkon përafrimin me *asquis communautaire*, shënohen numri CELEX, data e miratimit dhe titulli i plotë i instrumentit ligjor të *asquis communautaire*, me të cilin është përafruar projektakti. Referenca e instrumentit ligjor të *asquis communautaire* bëhet, nëpërmjet një shënimi në fund të faqes së parë të lidhur me titullin e projektaktit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**